



K. Bashk

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

Nr. 5248 Prot

Lezhë 22.04.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_\_ Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

**“ PËR DISA NDRYSHIME NE VKB NR 104, DATË 26.11.2025 "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE, TARIFAVE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE ATO ADMINSTRATIVE, LEHTËSIRAVE FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SË PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9920, datë “ Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, i ndyshuar, Kryetari i Bashkisë:

**PROPOZON :**

1. Të bëjë ndryshime në gërmen **D. 2.Penalitetet /Gjoha**, të shtohen pikat 7, 8, 9, 10dhe 11, si më poshtë:

Nr	Emertimi/Pershkrimi i shkeljes	Njësia	Niveli i gjobës/penalitetit Taksapaguesi	
			Familjarë	Biznes
7	Gjobë për mospajisje me licencë për agjenci funerale	Lekë		20,000
8	Gjobë për mospajisje me çertifikatë për agjenci/ shtëpi funerale	Lekë		10,000
9	Gjobë për ekspozim të artikujve industrial brenda dhe jashte objektit të agjencisë/ shtëpisë funerale	Lekë		20,000
10	Ekspozim i mjetit autofunebër në parkime dhe zona publike.	Lekë		20,000
11	Gjobë për shkelje të kushteve të Liçencës/Çertifikatës	Lekë		20,000

2. Pika 2a dhe 2b, hiqen dhe bëhen si më poshtë, shtohet pika 2.f :

Nr	Emertimi	Njësia	Familjarë	Biznes
2.a	Hedhja e mbetjeve jashtë orarit të caktuar	Lekë	10,000	20,000
2.b	Hedhja e mbetjeve jashtë pikave të grumbullimit të miratuara nga Bashkia	Lekë	10,000	20,000
2.f	Hedhja e mbetjeve pa qese.	Lekë	10,000	20,000

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Pjerin NDREU**





**BASHKIA LEZHË**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INFRASTRUKTURËS, TRANSPORTIT DHE**  
**MJEDISIT**

Nr. 5248/1 Prot,

Lezhë, me 22 . 04 .2026

**RELACION**

**“Mbi projekt-vendimin “Për disa ndryshime në VKB nr. 104, datë 26.11.2025 ‘Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave të shërbimeve publike dhe ato administrative, lehtësirave fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve”**

Në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi, konkretisht ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Vendimit nr.85 datë 30.09.2025 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve plotësuese që agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dhe/ose ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale, në lidhje me kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore” ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, paraqitet për miratim projekt-vendimi për disa ndryshime në VKB nr. 104, datë 26.11.2025. Ky projekt-vendim synon përmirësimin e mekanizmave rregullatorë dhe forcimin e instrumenteve ndëshkuese në funksion të garantimit të zbatimit të ligjshmërisë në territorin e Bashkisë Lezhë.

**Në fushën e shërbimeve funerale**, kontrollet e ushtruara nga strukturat përgjegjëse ka nxjerrë në pah raste të ushtrimit të aktivitetit pa dokumentacion të plotë ligjor, mungesë të certifikimeve përkatëse, si dhe mosrespektim të standardeve të përcaktuara për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Në këtë kontekst, projekt-vendimi parashikon ndryshime duke shtuar pika të reja që adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljet e konstatuara. Konkretisht, parashikohen:

1. gjoba për ushtrimin e aktivitetit pa licencë, për mungesën e certifikatës përkatëse, për ekspozimin e artikujve industrialë jashtë ambienteve të lejuara të aktivitetit;
2. për parkimin e mjeteve funerale në kundërshtim me rregullat në hapësira publike.;
3. për shkeljen e kushteve të licencës ose certificates;

Miratimi i këtij projekt-vendimi pritet të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve funerale, një sektor me ndjeshmëri të lartë për komunitetin. Garantimi i standardeve

të funksionimit dhe rritja e transparencës në këtë aktivitet kontribuon drejtpërdrejt në mbrojtjen e dinjitetit të qytetarëve dhe në rritjen e besimit ndaj institucioneve publike.

**Në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane**, nga verifikimet në terren janë konstatuar problematika të vazhdueshme që lidhen me hedhjen e mbetjeve jashtë orareve të përcaktuara duke krijuar vatra potenciale të hedhjes së mbetjeve në menyre të pakontrolluar. Këto masa synojnë të vendosin rregulla të qarta dhe të detyrueshme për të gjithë qytetarët dhe subjektet, duke forcuar përgjegjësinë individuale dhe kolektive në raport me mbrojtjen e mjedisit.

Pikat e reja të paraqitura në projekt-vendim:

1. Gjobë për hedhjen jashtë orarit të caktuar;
2. Gjobë për hedhjen jashtë pikave të grumbullimit të miratuara nga Bashkia;
3. Gjobë për hedhjen e mbetjeve pa qese;

Vendosja e këtyre penaliteteve bazohet në parimin e proporcionalitetit dhe të parandalimit, duke synuar jo vetëm ndëshkimin e shkeljeve, por edhe parandalimin e përsëritjes së tyre. Nga pikëpamja institucionale, këto ndryshime ndikojnë në rritjen e eficiencës së administratës vendore në ushtrimin e funksioneve të saj mbikëqyrëse dhe ndëshkuese. Ndarja më e qartë dhe më specifike e penaliteteve krijon mundësi për ndërhyrje të shpejtë dhe të drejtë, duke rritur nivelin e zbatueshmërisë së vendimeve të Këshillit Bashkiak.

**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**

